REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRISË

URDHËR

NR. 128, DATË 08/04/2016

PËR
MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR KONTROLLIN TEKNIK TË VLERËSIMIT TË KONFORMITETIT TË BOMBOLAVE TË GLN

Në mbështetje të ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar”, Vendimit Nr. 212 datë 16.3.2016 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngëzuar të naftës GLN”, si dhe të ligjit 10489/2011 “Për mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo-ushqimore”, i ndryshuar,

URDHËROJ

1. Fillimin e menjëhershëm të inspektimit teknik të vlerësimit të konformitetit të bombolave të GLN, të cilat:

    i. Nuk janë rregjistruar pranë Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial, sipas përcaktimeve të nenit 16 të ligjit 10489/2011 i ndryshuar;

    ii. Qarkullojnë në treg të pa pajisura me deklaratën e konformitetit të lëshuar prej prodhuesit;

    iii. Kanë me tepër se 5 vjet që qarkullojnë në treg të shoqëruara me deklaratën e konformitetit të lëshuar prej prodhuesit, dhe nuk i janë nënshtruar inspektimit teknik nga një organ i miratuar prej MEI, për vlerësimin e konformitetit të bombolave të GLN që përfshin të gjithë procesin e plotë të inspektimit përfshirë aksesorët nën presion të tyre;

    iv. qarkullojnë në treg të pa-pajisura me të dhënat dhe simbolet e poshtëshënuara:

        a) datën e prodhimit të bombolës,

        b) emrin e prodhuesit,

        c) numrin serial të bombolës,

d) datën e inspektimit fillestar, dhe datën e inspektimit të fundit teknik të kryer nga nje organ i miratuar sipas përcaktimeve të pikes ii, më sipër,

e) simbolin e flakës së ndezshme të dallueshme në sipërfaqen e bombolës,

f) të dhëna të markës tregtare të shoqërisë pronare apo poseduese të bombolës,

g) peshën neto dhe peshën bruto të bombolës,

h) ngjyrën përkatëse të shoqërisë pronare/poseduese, të deklaruar pranë ISHTI't, sipas dispozitave përkatëse ligjore;

v. nuk mbartin markimin përkatës të bombolës dhe të aksesoreve nën presion, të përcaktuar në dispozitat që rregullojnë fushën e pajisjeve të transportueshme nën presion (simbolet Π, UN, CE, etj.)

2. Procedura e inspektimit teknik të vlerësimit të konformitetit do të kryhet sipas përcaktimeve të paraqitura në Aneksin I të këtij Urdhri;

3. Pas rezultatit pozitiv të inspektimit të kryer ndaj bombolës dhe aksesorëve të saj nën prresion, shoqëritë e tregtimit me shumicë, të cilat janë të vetmet shoqëri të lejuara për mbushjen e bombolave me GLN sipas dispozitave ligjore në fuqi, do ti mbushin ato në perputhje dhe me përcaktimet e pikes 6 të Kreut III të VKM 212/2016 të sipërcituar;

4. Subjekti i autorizuar për kryerjen e inspektimit teknik të vlerësimit të konformitetit, në perputhje me dispozitat e pikës 2 të Kreut VIII të VKM 212/2016, do të jetë Organi i Miratuar i Vlerësimit të Konformitetit, trupa inspektuese EL-BU 2009 Sh.p.k. me numër OMI 011;

5. Shoqëritë e tregtimit me shumicë të GLN të autorizuara për mbushjen e bombolave të GLN sipas përcaktimeve të ligjit 8450/1999 i ndryshuar, duhet të nënshkruajnë një marrëveshje me trupën inspektuese EL-BU 2009 Sh.p.k, për të garantuar që gjithë bombolat që do të mbushen prej tyre, i janë nënshtruar inspektimit teknik të vlerësimit të konformitetit prej kësaj të fundit, dhe janë të pajisura me të gjithë elementet e nevojshëm për të garantuar përputhshmërinë me dispozitat ligjore në fuqi.

6. Shoqëritë e tregtimit me shumicë të GLN do të raportojnë pranë Inspektorati Shteteror Teknik dhe Industrial, si dhe ndaj trupës inspektuese EL-BU 2009 Sh.p.k, një regjistër të dhënash mbi bombolat e GLN që kanë në pronësi apo posedim, sipas modelit të tabelës së paraqitur në Aneksin II të këtij Urdhri;

7. Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial do të mbikeqyrë që të gjitha bombolat e GLN në qarkullim sipas përcaktimeve të VKM 212/2016, do të mbushen prej shoqërive të tregtimit me shumicë të GLN, vetëm nëse janë të pajisura me Deklaratën e Konformitetit të lëshuar prej prodhuesit brenda nje afati jo me shumë se 5 vjet nga data e hyrjes në fuqi të këtij Urdhri, dhe për ato që nuk janë të pajisura me Deklaraten e Konformitetit të lëshuar prej prodhuesit, vetëm pasi të jenë pajisur me Deklaraten e Konformitetit të lëshuar prej trupës inspektuese EL-BU 2009 Sh.p.k dhe mbartin shënjimet përkatëse të përcaktuara në ligjin 8450/1999 i ndryshuar dhe VKM 212/2016, të përmendura edhe në gërmat nga a) deri në h) të paragrafit iv) të pikes 1 të këtij urdhri.

8. Inspektorati Shteteror Teknik dhe Industrial, do të sigurojë se të gjitha bombolat e GLN subjekt i dispozitave të këtij Urdhri, do të raportohen në ISHTI rregullisht prej Shoqërive të tregtimit me shumicë të GLN dhe prej trupës inspektuese EL-BU 2009.

9. Inspektorati Shteteror Teknik dhe Industrial, do të sigurojë se të gjitha bombolat të cilat duhet të inspektohen sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor të sipërpërmendur, dhe sipas procedurave të përcaktuara në këtë Urdhër, duhet të përfundojë brenda një periudhe 12 mujore nga hyrja në fuqi e këtij Urdhri.

10. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohen Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Hidrokarbureve, Drejtoria e Politikave, Zhvillimit të Industrisë dhe Standardeve Teknike, si dhe Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI